



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.49/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Rafet Haxhaj dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në hapësira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ndërkaq subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 750 (shtatëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.09.2017, nga subjekti politik LVV, me të cilën ankesë pretendon se aktivistët tonë kanë vërejtur se me datë 22.09.2017, rreth orës 15:00 në rrugën “Fatmir Ukaj”, në rrethojat e murit të ndërmarrjes publike pra te Thertorja, ishte vendosur poster i kandidatit për kryetar të Komunës dhe kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal së Pejës nga radhët e subjektit politik LDK.

Me këtë rast parashtresuesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33, paragrafi 1, pika b, e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (Ligji Nr.03/L-073) dhe rregullës zgjedhore të KQZ-së nr. 11/2013 dhe 13/2013. PZAP-it i ka kërkuar që konform nenit 3.3.2 i rregullave dhe procedurave të PZAP-së (nr. 01/2012) subjektit politik LDK ti shqiptohet masa ndëshkimore. Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri fotografi të fotokopjuara nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës LDK, në përgjigjen në ankesë të datës 24.09.2017, ka theksuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar pasi që vendosja e çfarëdo materiali zgjedhor në “muret e ndërmarrjes publike” nuk përbënë shkelje, pasi që në këtë periudhë në mungesë të hapësirave të dedikuara për reklamim politik, përdoren mure të ndryshme të objekteve. Për më tepër ka shtuar se, subjekti politik LDK i ka ndërmarrë masat e duhura dhe ka evituar shkeljen e pretenduar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoj se :

Ankesa është e bazuar

Paneli, pasi vlerësoj pretendimet e parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e supozuar zgjedhore, me rastin e vendosjes së posterit të kandidatit për kryetar të Komunës dhe kandidatit për Anëtar të Kuvendit Komunal së Pejës nga radhët e subjektit politik LDK, në rrethojat e murit të ndërmarrjes publike pra te Thertorja, të vendosura në hapësira publike, Paneli nga fotografia e administruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës, e ofruar nga parashtruesi i ankesës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se këto veprime janë në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që e kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Ankesa 49/2017 më datën 25.09.2017.



**Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.